



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
MALLRA**

Objekti : ”Blerje uniforma per Zjarrfikesit dhe per Policime Bashkiake” ndare ne 2 lote

Fondi limit : 11,751,520 (njembedhjetemilion e shtateqind e pesedhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) leke pa tvsh

REF-97703-08-26-2026

Loti 1: Blerje Uniforma per Zjarrfikesit

Fondi limit 8,146,500 (tetemilione njëqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) leke pa tvsh

Kodi CPV:35811100-3-Uniforma zjarrfikesish

REF-97708-08-26-2026

Loti2: Blerje Uniforma per Policine Bashkiake

Fondi limit 3,605,020 (tremilion e gjashtëqind e pesë mijë e njëzet) leke pa tvsh

Kodi CPV:35811200-4-Uniforma policie

REF-97710-08-26-2026

Tipi i procedures: E Hapur

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOT11 :BLERJE UNIFORMA PER ZJARREFIKESIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **30 % e vlerës së fondit limit të lotit 1.**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.Kërkesa për disponimin e një niveli të caktuar të xhiros vjetore nga operatori ekonomik vendoset me qëllim garantimin e **kapacitetit ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.**Duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës dhe natyrën e furnizimit, kërkesa për xhiro synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë **kapacitet të mjaftueshëm financiar dhe qëndrueshmëri ekonomike** për të përballuar kostot e prodhimit/furnizimit, transportit, magazinimit dhe realizimit të detyrimeve kontraktore deri në përfundimin e furnizimit.Kjo kërkesë synon gjithashtu të reduktojë riskun e ndërprerjes ose vonesës së furnizimit dhe të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet kontraktore në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.Niveli i kërkuar i xhiros është përcaktuar duke pasur parasysh **vlerën e parashikuar të prokurimit dhe parimin e proporcionalitetit**, me qëllim që kërkesa të jetë e lidhur dhe e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës dhe të mos krijojë kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen në procedurë.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të balanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, sipas përcaktimeve ligjore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kërkesa për paraqitjen e balanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025** është përcaktuar me qëllim verifikimin e **kapacitetit ekonomik dhe financiar** të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së tyre financiare për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata.Bilancet dhe pasqyrat financiare

përbëjnë dokumentacionin financiar të nevojshëm për të vlerësuar gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik, duke i dhënë autoritetit kontraktor mundësinë të verifikojë nëse operatori ka një situatë financiare të qëndrueshme dhe aftësi për të përballuar detyrimet financiare që lidhen me realizimin e kontratës. Kërkesa për **tre vite financiare të njëpasnjëshme** është vendosur për të siguruar një vlerësim më të plotë të gjendjes financiare të operatorit ekonomik dhe për të shmangur vlerësimin e kapacitetit financiar vetëm mbi bazën e një viti të vetëm. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor mund të evidentojë nëse gjendja financiare e operatorit ka qenë e qëndrueshme në kohë. Përcaktimi që kriteri konsiderohet i përmbushur kur, në **dy nga tre bilancet e kërkuara**, nuk rezulton gjendje financiare negative, synon të shmangë përjashtimin e operatorëve ekonomikë për shkak të një rezultati financiar jo të favorshëm në një vit të vetëm, duke vlerësuar në mënyrë më proporcionale dhe objektive qëndrueshmërinë e tyre financiare. Kërkesa që bilancet të jenë **të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse** synon të garantojë autenticitetin dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit financiar të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në rastet kur operatori ekonomik është subjekt i auditimit ligjor sipas **nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009**, kërkesa për paraqitjen e raporteve të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është e nevojshme për të siguruar një verifikim të pavarur të informacionit financiar të paraqitur dhe është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës. Nga pikëpamja teknike dhe ekonomike, ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik që do të realizojë kontratën të ketë **kapacitet të mjaftueshëm financiar, stabilitet ekonomik dhe aftësi për të përballuar kostot dhe detyrimet që mund të lindin gjatë zbatimit të saj**, duke reduktuar riskun e ndërprerjes ose mosrealizimit të kontratës për shkaqe financiare. Kriteri është vendosur në përputhje me parimet e **proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë**, pasi kërkesa lidhet me objektin dhe natyrën e kontratës dhe nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë që operatorët pjesëmarrës të kenë kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e saj.

2.2.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për keestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni,

si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

Kërkesa për vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore është vendosur për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore të operatorit ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore. Verifikimi për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ushtron aktivitet, sipas të dhënave të QKB-së, siguron kontroll të plotë të detyrimeve të tij vendore. Kriteri është i lidhur me gjendjen ligjore të operatorit ekonomik dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë ofertuesit, ndërsa dokumentacioni provues kërkohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari sipas përcaktimeve të DST.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 30 % e vlerës së fondit limit të lotit 1**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm,

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Argumentimi Teknik : Kërkesa për paraqitjen e kontratave të ngjashme synon të garantojë që operatori ekonomik disponon eksperiencën dhe kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin e furnizimit objekt prokurimi. Furnizimi me uniforma për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit paraqet kërkesa specifike lidhur me cilësinë e materialeve, përpunimin, qëndrueshmërinë, sigurinë dhe përputhshmërinë me standardet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë përvojë të mëparshme në realizimin e furnizimeve të një natyre të ngjashme. Kërkesa për kontrata të ngjashme shërben për të verifikuar aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar në mënyrë të suksesshme furnizime me uniforma profesionale, veshje pune, veshje mbrojtëse dhe/ose pajisje personale mbrojtëse, të krahasueshme për nga natyra dhe kompleksiteti me objektin e prokurimit. Ky kriter synon të ulë riskun e mosrealizimit ose realizimit me cilësi të papërshtatshme të furnizimit dhe të garantojë përmbushjen e kërkesave teknike, cilësore dhe të sigurisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke respektuar njëkohësisht parimin e proporcionalitetit dhe të moskufizimit të konkurrencës.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të vlefshëm nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për artikujt objekt prokurimi. Në rast se operatori ekonomik paraqet autorizim të lëshuar nga një distributor, duhet të paraqitet edhe dokumentacion që provon lidhjen dhe të drejtën e distributorit për të autorizuar operatorë ekonomikë për furnizimin e artikujve objekt prokurimi. Kjo lidhje duhet të jetë e dokumentuar në mënyrë të qartë, nëpërmjet autorizimit, marrëveshjes së distributorshit ose dokumenteve të tjera të vlefshme të lëshuara nga prodhuesi. Dokumentacioni i paraqitur duhet të mundësojë verifikimin e zinxhirit të autorizimit nga prodhuesi deri te operatori ekonomik ofertues, për artikujt objekt prokurimi.

Argumentimi: Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e **autorizimit të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar** vendoset me qëllim garantimin e **origjinës, autenticitetit dhe përputhshmërisë së produkteve** objekt prokurimi me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Duke marrë në konsideratë natyrën e uniformave dhe pajisjeve të përdorura nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të cilat duhet të përmbushin kërkesa të veçanta lidhur me **cilësinë, sigurinë, materialet, standardet teknike dhe qëndrueshmërinë në kushte të vështira pune**, është e nevojshme të sigurohet që produktet e ofruara vijnë nga një burim i identifikueshëm dhe i autorizuar. Autorizimi synon gjithashtu të garantojë **gjurmueshmërinë e produkteve dhe përgjegjshmërinë e zinxhirit të furnizimit**, si dhe të krijojë mundësi për verifikimin e origjinës dhe karakteristikave teknike të artikujve të ofruar. Në rastin kur autorizimi paraqitet nga një distributor, kërkesa për dokumentacionin që provon lidhjen e tij me prodhuesin synon të garantojë se distributori **disponon të drejtën për të furnizuar dhe autorizuar operatorë ekonomikë për produktet objekt prokurimi**. Kriteri është vendosur në funksion të sigurimit të **cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë së furnizimit**, si dhe të uljes së riskut të furnizimit me produkte që nuk përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun teknik të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi të Lotit 1, ku të identifikohen qartë produktet e ofruara dhe karakteristikat e tyre teknike. Katalogu duhet të mundësojë verifikimin e përputhshmërisë së artikujve të ofruar me specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore/VKM-në përkatëse për uniformat dhe pajisjet e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.Katalogu duhet të përmbajë, sipas rastit, të dhëna mbi modelin, materialin, përbërjen, përmasat, standardet e aplikueshme dhe karakteristikat e tjera teknike të kërkuara për artikujt objekt prokurimi. Në rast se të dhënat e katalogut nuk janë në gjuhën shqipe, operatori ekonomik duhet të paraqesë përkthimin përkatës në gjuhën shqipe, sipas kërkesave të përcaktuara në DT.

a) **Argumentimi** Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 6/b ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit

b) **fotografitë apo katalogët teknikë;**

Kërkesa për paraqitjen e katalogut teknik të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi vendoset me qëllim mundësimin e verifikimit të karakteristikave teknike dhe të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.Duke marrë në konsideratë natyrën e uniformave dhe pajisjeve të përdorura nga punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesa të veçanta për mbrojtjen, sigurinë, cilësinë, materialet, qëndrueshmërinë dhe standardet teknike, katalogu teknik shërben si një dokument i nevojshëm për identifikimin e qartë të produkteve të ofruara.Nëpërmjet katalogut teknik Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë prodhuesin, modelin, materialin, përbërjen, karakteristikat teknike, standardet e aplikueshme dhe elementet e tjera të produktit, si dhe përputhjen e tyre me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në DST.Kërkesa për katalog teknik synon gjithashtu të shmangë ofrimin e produkteve të paidentifikueshme ose të ndryshme nga ato të specifikuara në ofertë dhe të sigurojë transparencë, gjurmueshmëri dhe kontroll të cilësisë së produkteve gjatë procesit të vlerësimit dhe zbatimit të kontratës.Për sa më sipër, paraqitja e katalogut teknik vlerësohet e nevojshme dhe proporcionale me natyrën e objektit të prokurimit, pasi mundëson verifikimin objektiv të përputhshmërisë së mallrave të ofruara me kërkesat teknike dhe të siguriisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4.Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatë të vlefshme:

SSH EN ISO 9001 "Sisteme të menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë nga një organizëm certifikues i

akredituar sipas standardeve ndërkombëtare dhe të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës.

Ne rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik, cdo anetar I grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marr persiper të realizojë sipas akt-marreveshjes

Argumentimi Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. Kërkesa për paraqitjen e **certifikatës ISO 9001:2015** justifikohet me nevojën për të garantuar që prodhuesi i uniformave disponon një **sistem të standardizuar të menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë** gjatë procesit të prodhimit. Duke marrë në konsideratë natyrën e uniformave të përdorura nga punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të cilat duhet të përmbushin kërkesa të përcaktuara për cilësinë, qëndrueshmërinë, përpunimin dhe përputhshmërinë me specifikimet teknike të DST, zbatimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë ndihmon në sigurimin e një procesi të kontrolluar dhe të qëndrueshëm prodhimi. Certifikimi sipas **ISO 9001:2015** synon të sigurojë që proceset e prodhimit dhe kontrollit të cilësisë së prodhuesit janë të organizuara dhe të monitoruara në mënyrë të vazhdueshme, duke reduktuar riskun e mospërputhjes së produkteve me kërkesat teknike të përcaktuara. Kërkesa është e lidhur me objektin e prokurimit dhe synon të garantojë **qëndrueshmërinë dhe kontrollin e cilësisë së furnizimit**, pa zëvendësuar certifikatat, testet apo dokumentet specifike të konformitetit që kërkohen për pajisjet personale mbrojtëse dhe standardet përkatëse të sigurisë.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës të konformitetit, të lëshuar nga prodhuesi dhe/ose nga një organ i autorizuar/kompetent, në përputhje me kërkesat e Rregullores (BE) 2016/425, ose standardeve/rregullave ekuivalente, për pajisjet personale mbrojtëse (PPE) të parashikuara në Lotin 1, konkretisht: xhakëtë, pantallona, doreza, helmetë zjarrfikëse, çizme zjarrfikëse dhe kapuç, sipas standardeve të mbrojtjes dhe sigurisë të përcaktuara në specifikimet teknike të Dokumenteve të Tenderit (DST).

Dokumentacioni i paraqitur duhet të mundësojë verifikimin e përputhshmërisë së secilit produkt me kërkesat teknike dhe standardet përkatëse të sigurisë të përcaktuara në DST

Argumentimi: Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit përkatës të konformitetit për artikujt e Lotit 1 vendoset për të garantuar që **pajisjet personale mbrojtëse (PPE)** të ofruara për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit përmbushin kërkesat e përcaktuara për **sigurinë, mbrojtjen dhe performancën teknike**. Duke marrë në konsideratë kushtet e veçanta dhe potencialisht të rrezikshme në të cilat ushtrojnë detyrën punonjësit zjarrfikës, është e domosdoshme që pajisjet mbrojtëse, konkretisht **xhakët, pantallona, doreza, helmetë zjarrfikëse, çizme zjarrfikëse dhe kapuç**, të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet përkatëse të sigurisë. Dokumentacioni i konformitetit shërben për të mundësuar **verifikimin objektiv të përputhshmërisë së secilit produkt** me kërkesat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe me standardet/rregullat e aplikueshme për pajisjet personale mbrojtëse. Ky dokumentacion garanton gjithashtu **gjurmueshmërinë dhe identifikimin e produkteve**, si dhe ofron siguri mbi karakteristikat dhe performancën e tyre të deklaruar. Kërkesa për dokumentacionin e konformitetit sipas **Rregullores (BE) 2016/425**, ose sipas kërkesave dhe standardeve ekuivalente të aplikueshme, synon të sigurojë që produktet e ofruara janë vlerësuar dhe dokumentuar në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë dhe mbrojtjes. Për sa më sipër, ky kriter vlerësohet i nevojshëm dhe proporcional me natyrën e objektit të prokurimit, pasi lidhet drejtpërdrejt me **sigurinë e përdoruesve dhe funksionin mbrojtës të pajisjeve**, dhe shërben si një mjet objektiv për verifikimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve të ofruara.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon

produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim teknik për specifikimet teknike

Specifikimet teknike të përcaktuara për **uniformat dhe pajisjet e punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit** janë hartuar duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të funksionit që kryejnë këta punonjës dhe kushtet e vështira dhe potencialisht të rrezikshme në të cilat zhvillohet aktiviteti i tyre. Kërkesat teknike për materialet, përpunimin, përmasat, konstruksionin, rezistencën, elementët reflektues, aksesoret dhe karakteristikat e tjera të artikujve synojnë të garantojnë **mbrojtjen, sigurinë, funksionalitetin, komoditetin dhe qëndrueshmërinë** e uniformave gjatë përdorimit në operacione zjarrfikëse dhe të shpëtimit. Specifikimet teknike janë përcaktuar në përputhje me **kërkesat e parashikuara në aktet nënligjore/VKM-në përkatëse**, si dhe me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë të aplikueshme për pajisjet personale mbrojtëse, duke siguruar që produktet e furnizuara të jenë të përshtatshme për qëllimin e tyre të përdorimit. Përcaktimi i karakteristikave të materialeve dhe i kërkesave të performancës është i nevojshëm për të garantuar **qëndrueshmërinë ndaj përdorimit intensiv, kushteve atmosferike, temperaturave të larta, konsumimit dhe mirëmbajtjes së përsëritur**, në varësi të funksionit të secilit artikull. Elementët reflektues dhe identifikues të parashikuar në uniformë kanë për qëllim të rrisin **dukshmërinë dhe identifikimin e punonjësit**, veçanërisht gjatë operacioneve në kushte me ndriçim të kufizuar ose dukshmëri të reduktuar. Për pajisjet personale mbrojtëse, kërkesat teknike janë përcaktuar në mënyrë që të mundësohet verifikimi i **përputhshmërisë së produkteve me standardet dhe dokumentacionin përkatës të konformitetit**, duke garantuar nivelin e nevojshëm të sigurisë për përdoruesit.

LOTI 2 :BLERJE UNIFORMA PER POLICINE BASHKIAKE

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas*

parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30 % e vlerës së fondit limit të lotit 2.**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.Kërkesa për disponimin e një niveli të caktuar të xhiros vjetore nga operatori ekonomik vendoset me qëllim garantimin e **kapacitetit ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.**Duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës dhe natyrën e furnizimit, kërkesa për xhiro synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë **kapacitet të mjaftueshëm financiar dhe qëndrueshmëri ekonomike** për të përballuar kostot e prodhimit/furnizimit, transportit, magazinimit dhe realizimit të detyrimeve kontraktore deri në përfundimin e furnizimit.Kjo kërkesë synon gjithashtu të reduktojë riskun e ndërprerjes ose vonësës së furnizimit dhe të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin e nevojshëm për të

përmbushur detyrimet kontraktore në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Niveli i kërkuar i xhiros është përcaktuar duke pasur parasysh **vlerën e parashikuar të prokurimit dhe parimin e proporcionalitetit**, me qëllim që kërkesa të jetë e lidhur dhe e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës dhe të mos krijojë kufizime të panevojshme për pjesëmartjen në procedurë.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të balanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, sipas përcaktimeve ligjore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kërkesa për paraqitjen e balanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025** është përcaktuar me qëllim verifikimin e **kapacitetit ekonomik dhe financiar** të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së tyre financiare për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Bilancet dhe pasqyrat financiare përbëjnë dokumentacionin financiar të nevojshëm për të vlerësuar gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik, duke i dhënë autoritetit kontraktor mundësinë të verifikojë nëse operatori ka një situatë financiare të qëndrueshme dhe aftësi për të përballuar detyrimet financiare që lidhen me realizimin e kontratës. Kërkesa për **tre vite financiare të njëpasnjëshme** është vendosur për të siguruar një vlerësim më të plotë të gjendjes financiare të operatorit ekonomik dhe për të shmangur vlerësimin e kapacitetit financiar vetëm mbi bazën e një viti të vetëm. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor mund të evidentojë nëse gjendja financiare e operatorit ka qenë e qëndrueshme në kohë. Përcaktimi që kriteri konsiderohet i përmbushur kur, në **dy nga tre bilancet e kërkuara**, nuk rezulton gjendje financiare negative, synon të shmangë përjashtimin e operatorëve ekonomikë për shkak të një rezultati financiar jo të favorshëm në një vit të vetëm, duke vlerësuar në mënyrë më proporcionale dhe objektive qëndrueshmërinë e tyre financiare. Kërkesa që bilancet të jenë **të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse** synon të garantojë autenticitetin dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit financiar të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në rastet kur operatori ekonomik është subjekt i auditimit ligjor sipas **nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009**, kërkesa për paraqitjen e raporteve të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është e nevojshme për të siguruar një verifikim të pavarur të informacionit financiar të paraqitur dhe është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës. Nga pikëpamja teknike dhe ekonomike, ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik që do të realizojë kontratën të ketë **kapacitet të mjaftueshëm financiar, stabilitet ekonomik dhe aftësi për të përballuar kostot dhe detyrimet që mund të lindin gjatë zbatimit të saj**, duke reduktuar riskun e ndërprerjes ose mosrealizimit të kontratës për shkaqe financiare. Kriteri është

vendosur në përputhje me parimet e **proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë**, pasi kërkesa lidhet me objektin dhe natyrën e kontratës dhe nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë që operatorët pjesëmarrës të kenë kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e saj.

2.2.3.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për keestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

Kërkesa për vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore është vendosur për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore të operatorit ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore. Verifikimi për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ushtron aktivitet, sipas të dhënave të QKB-së, siguron kontroll të plotë të detyrimeve të tij vendore. Kriteri është i lidhur me gjendjen ligjore të operatorit ekonomik dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë ofertuesit, ndërsa dokumentacioni provues kërkohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari sipas përcaktimeve të DST.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 30 % e vlerës së fondit limit të lotit 1**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të

kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- c. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm,

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Argumentimi Teknik : Kërkesa për paraqitjen e kontratave të ngjashme synon të garantojë që operatori ekonomik disponon eksperiencën dhe kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin e furnizimit objekt prokurimi. Furnizimi me uniforma për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit paraqet kërkesa specifike lidhur me cilësinë e materialeve, përpunimin, qëndrueshmërinë, sigurinë dhe përputhshmërinë me standardet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë përvojë të mëparshme në realizimin e furnizimeve të një natyre të ngjashme. Kërkesa për kontrata të ngjashme shërben për të verifikuar aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar në mënyrë të suksesshme furnizime me uniforma profesionale, veshje pune, veshje mbrojtëse dhe/ose pajisje personale mbrojtëse, të krahasueshme për nga natyra dhe kompleksiteti me objektin e prokurimit. Ky kriter synon të ulë riskun e mosrealizimit ose realizimit me cilësi të papërshtatshme të furnizimit dhe të garantojë përmbushjen e kërkesave teknike, cilësore dhe të sigurisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke respektuar njëkohësisht parimin e proporcionalitetit dhe të moskufizimit të konkurrencës.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të vlefshëm nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për artikujt objekt prokurimi.Në rast se operatori ekonomik paraqet autorizim të lëshuar nga një distributor, duhet të paraqitet edhe dokumentacion që provon lidhjen dhe të drejtën e distributorit për të autorizuar operatorë ekonomikë për furnizimin e artikujve objekt prokurimi. Kjo lidhje duhet të jetë e dokumentuar në mënyrë të qartë, nëpërmjet autorizimit, marrëveshjes së distributorshit ose dokumenteve të tjera të vlefshme të lëshuara nga prodhuesi. Dokumentacioni i paraqitur duhet të mundësojë verifikimin e zinxhirit të autorizimit nga prodhuesi deri te operatori ekonomik ofertues, për artikujt objekt prokurimi.

Argumentimi: Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të .Kërkesa për paraqitjen e një autorizimi të vlefshëm nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për artikujt objekt prokurimi të Lotit 2 vendoset me qëllim garantimin e origjinës, autenticitetit dhe gjurmueshmërisë së uniformave të Policisë Bashkiake.Duke marrë në konsideratë se uniformat e Policisë Bashkiake duhet të jenë në përputhje me modelin, ngjyrat, materialet, elementet identifikuese, shenjat dalluese dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse dhe në specifikimet teknike të Dokumenteve të Tenderit, është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikojë burimin dhe origjinën e artikujve të ofruar.Në rastin kur autorizimi paraqitet nga një distributor, kërkesa për dokumentacionin që provon lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit synon të garantojë se distributori është i autorizuar për shpërndarjen e produkteve dhe për lëshimin e autorizimeve për furnizimin e tyre, duke mundësuar verifikimin e zinxhirit të autorizimit nga prodhuesi deri te operatori ekonomik ofertues.Dokumentacioni i paraqitur do t'i mundësojë Autoritetit Kontraktor të verifikojë identitetin e prodhuesit, origjinën e produkteve dhe të drejtën e operatorit ekonomik për furnizimin e artikujve të ofruar, si dhe të sigurojë që uniformat e furnizuara janë produkte të identifikueshme dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara.Kriteri synon gjithashtu garantimin e njëtrajtshmërisë dhe standardizimit të uniformave të Policisë Bashkiake, duke reduktuar riskun e furnizimit me produkte të ndryshme nga modeli dhe karakteristikat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.Për sa më sipër, kërkesa për autorizim vlerësohet e nevojshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit, pasi shërben për garantimin e origjinës, cilësisë, gjurmueshmërisë dhe përputhshmërisë së uniformave me kërkesat teknike dhe rregullatore të përcaktuara për Policinë Bashkiake.

2.3.3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalog, fletë teknike ose dokument tjetër teknik të prodhuesit**, për artikujt objekt prokurimi, nëpërmjet të cilit të mundësohet verifikimi i përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe kërkesat për uniformën e Policisë Bashkiake të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse. Në rast se të dhënat e katalogut nuk janë në gjuhën shqipe, operatori ekonomik duhet të paraqesë përkthimin përkatës në gjuhën shqipe, sipas kërkesave të përcaktuara në DT.

Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 6/b ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit

b) fotografitë apo katalogët teknikë

Kërkesa për paraqitjen e katalogut, fletës teknike ose dokumentit tjetër teknik të prodhuesit vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të identifikojë dhe verifikojë në mënyrë objektive karakteristikat e produkteve të ofruara.Uniformat e Policisë Bashkiake duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse, si dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, lidhur me modelin,

materialet, ngjyrat, përmasat, elementet identifikuese, shenjat dalluese dhe karakteristikat e tjera të uniformës.

Katalogu ose dokumentacioni teknik i prodhuesit shërben si mjet verifikimi i përputhshmërisë së produktit të ofruar me kërkesat teknike, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktor të vlerësojë në mënyrë të dokumentuar nëse produktet e propozuara përmbushin karakteristikat e kërkuara dhe nëse janë të identifikueshme nga pikëpamja e prodhuesit dhe modelit. Kërkesa për përkthimin në gjuhën shqipe, kur dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, synon të sigurojë qartësi dhe njëtrajtshmëri në shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Përcaktimi i këtij kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është i nevojshëm për të garantuar që furnizimi përfundimtar të jetë në përputhje me kërkesat teknike dhe rregullatore të përcaktuara për uniformat e Policisë Bashkiake, duke respektuar parimet e proporcionalitetit dhe të transparencës.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatë të vlefshme:

SSH EN ISO 9001 "Sisteme të menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë nga një organizëm certifikues i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare dhe të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës.

Ne rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik, cdo anëtar I grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marrë për të realizuar sipas akt-marreveshjes

Argumentimi Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. Kërkesa për disponimin e një certifikate të vlefshme SSH EN ISO 9001 – "Sisteme të menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente, vendoset me qëllim garantimin e një niveli të qëndrueshëm të menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit dhe/ose furnizimit të uniformave të Policisë Bashkiake. Uniformat e Policisë Bashkiake përbëjnë një kategori të standardizuar veshjesh, karakteristikat e të cilave përcaktohen nga kërkesat e akteve nënligjore përkatëse dhe specifikimet teknike të Dokumenteve të

Tenderit. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron kontrollin e proceseve dhe qëndrueshmërinë e cilësisë së produkteve të furnizuara.

Certifikimi sipas SSH EN ISO 9001 dëshmon se operatori ekonomik ka të përcaktuar dhe zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë, me procese për kontrollin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo synon të reduktojë riskun e furnizimit me produkte që nuk përputhen me kërkesat teknike të përcaktuara, veçanërisht për sa i përket materialeve, përpunimit, ngjyrave, përmasave, elementeve identifikuese dhe njëtrajtshmërisë së uniformave. Kërkesa për një certifikatë të vlefshme dhe të lëshuar nga një organ kompetent dhe i akredituar synon të sigurojë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e certifikimit, si dhe mundësinë e verifikimit të tij. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikatën ISO 9001 sipas pjesës së furnizimit që merr përsipër të realizojë, lidhet me nevojën për të garantuar që çdo pjesë e objektit të kontratës që realizohet nga anëtari përkatës i bashkimit të jetë subjekt i një sistemi të menaxhimit të cilësisë të përshtatshëm me aktivitetin që ai merr përsipër. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon garantimin e cilësisë, standardizimit, njëtrajtshmërisë dhe përputhshmërisë së uniformave të furnizuara, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe duke lejuar paraqitjen e certifikatave ekuivalente.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar, nëpërmjet së cilës deklaron se artikujt e ofruar janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST dhe me kërkesat përkatëse të përcaktuara në VKM për uniformën e Policisë Bashkiake. Deklarata duhet të përfshijë të gjithë artikujt dhe të identifikojë qartë produktet e ofruara.

Argumentimi. Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e një deklarate të nënshkruar për përputhshmërinë e artikujve të ofruar vendoset me qëllim që operatori ekonomik të marrë përsipër në mënyrë të shprehur përgjegjësinë për përputhjen e produkteve të ofruara me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Uniformat e Policisë Bashkiake kanë karakteristika të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse, si dhe në specifikimet teknike të Dokumenteve të Tenderit. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të deklarojë qartë se produktet që propozon për furnizim përmes këtyre kërkesave. Deklarata e nënshkruar shërben si një mjet i qartë dhe i verifikueshëm dokumentar, nëpërmjet të cilit operatori ekonomik identifikon produktet e ofruara dhe konfirmon përputhshmërinë e tyre me kërkesat teknike të procedurës. Identifikimi i secilit artikull shmanë paqartësitë gjatë procesit të vlerësimit dhe mundëson krahasimin e ofertës me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Kërkesa synon gjithashtu të reduktojë riskun e furnizimit me artikuj të ndryshëm nga ata të deklaruar në ofertë dhe të sigurojë që, gjatë zbatimit të kontratës, produktet e furnizuara të jenë të njëjta me produktet e identifikuar dhe të vlerësuara gjatë procedurës së prokurimit. Për sa më sipër, kërkesa për deklaratën e përputhshmërisë është e lidhur

drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është e nevojshme për të garantuar qartësinë, gjurmueshmërinë dhe përputhshmërinë e furnizimit me kërkesat teknike dhe rregullatore të përcaktuara për uniformat e Policisë Bashkiake.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX® STANDARD 100 ose certifikatë ekuivalente, për materialet tekstile të përdorura në artikujt objekt prokurimi, të lëshuar në emër të operatorit ekonomik ose të prodhuesit të materialeve/produkteve, në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të mbulojë materialet tekstile të përdorura në prodhimin e uniformave objekt prokurimi. Dokumentacioni i paraqitur duhet të mundësojë identifikimin e materialit/produktit të certifikuar dhe lidhjen e tij me artikujt e ofruar.

Argumentimi: Kriteri i vendosur, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 40 pika 8 ku citohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa për certifikatën OEKO-TEX® STANDARD 100 ose ekuivalente vendoset me qëllim garantimin e sigurisë dhe cilësisë së materialeve tekstile të përdorura në prodhimin e uniformave të Policisë Bashkiake. Duke qenë se uniformat janë në kontakt të vazhdueshëm me trupin e përdoruesit, është e nevojshme që materialet e përdorura në përbërjen e tyre të jenë të kontrolluara për substanca të dëmshme dhe të përmbushin kërkesat përkatëse të sigurisë së produkteve tekstile. Certifikimi shërben si një mjet objektiv verifikimi për të dëshmuar se materialet e ofruara janë testuar sipas kërkesave të përcaktuara nga skema përkatëse dhe përmbushin kufijtë e përcaktuar për substancat e kontrolluara. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me cilësinë dhe sigurinë e uniformave dhe nuk ndikon në karakteristikat e përcaktuara në VKM për modelin, ngjyrën, elementet identifikuese dhe karakteristikat e tjera të uniformës. Pranimi i dokumenteve ekuivalente siguron respektimin e parimit të konkurrencës dhe shmang kufizimin e panevojshëm të pjesëmarrjes. Njësia e Prokurimit gjykon se kërkesa për paraqitjen e **certifikatës OEKO-TEX® STANDARD 100 ose ekuivalente** është e nevojshme, duke marrë në konsideratë natyrën e artikujve objekt prokurimi, të cilët janë produkte tekstile që përdoren në mënyrë të përsëritur dhe kanë kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me lëkurën e përdoruesit. Kërkesa synon të garantojë që materialet dhe komponentët e përdorur në prodhimin e uniformave të jenë **të testuar dhe të vlerësuar për praninë e substancave të dëmshme**, në përputhje me kërkesat dhe kufijtë e përcaktuar nga skema përkatëse e certifikimit. **OEKO-TEX® STANDARD 100** konfirmon, në bazë të testeve të kryera sipas kërkesave të skemës së certifikimit, se produkti përmbush kufijtë e përcaktuar për substancat e kontrolluara dhe të kufizuara sipas kërkesave të certifikimit. "Kërkesa lidhet me nevojën për të garantuar **sigurinë, cilësinë dhe përshtatshmërinë e materialeve tekstile për përdoruesin përfundimtar**, duke reduktuar riskun e përdorimit të materialeve që përmbajnë substanca të kufizuara ose të dëmshme mbi nivelet e lejuara. Nëpërmjet paraqitjes së kësaj certifikate, Autoriteti Kontraktor siguron një **mjet objektiv dhe të dokumentuar për verifikimin e karakteristikave të materialeve të ofruara**, duke rritur nivelin e sigurisë dhe besueshmërisë së produkteve që do të furnizohen. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të garantojë **cilësinë dhe sigurinë e uniformave**, duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Për të mos kufizuar konkurrencën, pranohet edhe **dokumentacion ekuivalent** që

demonstron të njëjtin nivel kontrolli dhe sigurie për substancat e dëmshme në produktet tekstile.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim teknik

Specifikimet teknike të përcaktuara për uniformat e Policisë Bashkiake janë hartuar në përputhje me kërkesat dhe karakteristikat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse, konkretisht VKM-në për uniformën e Policisë Bashkiake, duke garantuar respektimin e modelit, paraqitjes, ngjyrave, materialeve, elementeve identifikuese, shenjave dalluese dhe karakteristikave të tjera të përcaktuara për uniformën.

Përcaktimi i këtyre specifikimeve është i nevojshëm për të garantuar njëtrajtshmërinë dhe standardizimin e uniformave të punonjësve të Policisë Bashkiake, si dhe identifikimin e qartë të tyre gjatë ushtrimit të funksioneve.

Kërkesat teknike për materialet, përmasat, përpunimin, ngjyrat dhe elementet dalluese janë përcaktuar në funksion të përdorimit të përditshëm, qëndrueshmërisë, komoditetit dhe paraqitjes së rregullt institucionale të uniformave, duke siguruar që produktet e furnizuara të jenë të përshtatshme për funksionin dhe përdorimin e tyre.

Referimi të kërkesat e VKM-së siguron që Autoriteti Kontraktor të mos përcaktojë karakteristika arbitrare apo të lidhura me një prodhues të veçantë, por të zbatojë kërkesa të standardizuara dhe të përcaktuara në aktin përkatës, të cilat duhet të respektohen gjatë furnizimit.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të mundësojnë verifikimin objektiv të përputhshmërisë së artikujve të ofruar, si gjatë vlerësimit të ofertave, ashtu edhe gjatë marrjes në dorëzim të mallrave.

Për sa më sipër, specifikimet teknike të përcaktuara janë të nevojshme dhe të justifikuara për garantimin e uniformitetit, identifikimit, cilësisë, funksionalitetit dhe përputhshmërisë së uniformave të Policisë Bashkiake me kërkesat rregullatore, si dhe për përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor.

NJESIA E PROKURIMIT